



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	17.05.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Kosova Bike Group - Grupi i Çiklistëve të Kosovës
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga Kosova Bike Group - Grupi i Çiklistëve të Kosovës në bashkëpunim me Adventure Trips Kosovo dhe Federatën e Çiklizmit të Kosovës me të cilën kërkohet që me datë 19 dhe 26 Maj 2021 nga ora 20:00 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike „Sheshi ”Ibrahim Rugova” ku do të jetë vendtakimi duke vazhduar sipas rutës së paraqitur në kërkesë.

Ky aktivitet do të mbahet me qëllim të sensibilizimit dhe vetëdijesimit e qytetarëve për sigurinë e çiklistëve në trafik dhe rritjen e dukshmërisë në komunikacion.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronë Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Ibrahim Rugova” me datën 19 dhe 26 Maj 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.